



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

**AFTER SCHOOL SUPPORT
FOR TEENS**

Shkathtësitë e buta për jetë dhe punë – listë kontrolluese për nxënës

Nxënës të dashur,

Programi i USAID-it, “Përkrahje Adoleshentëve pas Mësimit të Rregullt” (ang. After School Support for Teens- ASSET), ka përzgjedhur një grup prej dhjetë shkathtësive të buta që kontibujnë në përgatitjen e të rinjve për punësim.

Programi ASSET promovon zhvillimin e këtyre shkathtësive të nxënësve të shkollave të mesme të larta nëpërmjet aktiviteteve në kuadër të procesit mësimor dhe atyre jashtëkurrikulare. Përmes këtyre aktiviteteve, Programi ASSET ndihmon në zhvillimin e shkathtësive, kompetencave dhe qëndrimeve që janë të nevojshme për punësimin e të rinjve, edukimin e mëtutjeshëm dhe avancimin në karrierë.

Dhjetë shkathtësitë e promovuara nga Programi ASSET, si dhe treguesit për secilën shkathtësi janë dhënë në vijim.

Ju inkurajojmë që të lexoni secilën shkathtësi dhe të gjeni nëse i posedoni ato, apo nëse keni nevojë t'i zhvilloni më tutje.

Të menduarit kritik

Të menduarit kritik paraqet shkathtësinë për të arsyetuar në mënyrë efektive duke përdorur informacione të tilla si: të dhëna, fakte, fenomene të dukshme, dhe gjetje të hulumtimeve. Një mendimarr i mirë kritik arrin në përfundime të arsyeshme nga një grup informacionesh, si dhe dallon informatat e besueshme prej atyre jo të besueshme për të paraqitur arsye koherente përse ka marrë një pozicion, ka paraqitur një propozim ose deklaram.

■ E kuptoj domethënien e të menduarit kritik

■ Përdor fakte relevante për të ndërtuar argumente

■ Krahasoj dhe shqyrtoj mendime

■ Bëj gjykime duke përdorur kritere dhe standarde të përshtatshme

■ Arsyetoj argumentet logjikisht

■ Identifikoj të pavërtetat/gabimet në arsyetim

■ Marr parasysh kontekstin më të gjerë para se të marr një pozicion

■ Vlerësoj pasojat praktike të propozimeve dhe vendimeve

■ Përdor të dhëna sasiore për të mbështetur argumentet

■ E vlerësoj rëndësinë e burimeve të fakteve

Programi ASSET financohet nga USAID dhe zbatohet nga Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në partneritet me Fhi360 dhe Crimson Capital Corp.

Komunikimi

Komunikimi i referohet shkathtësisë për të artikuluar mendime dhe ide në mënyrë efektive duke përdorur komunikim me gojë, me shkrim, dhe komunikimin joverbal në kontekste të ndryshme; për të përzgjedhur strategjitë për të komunikuar në mënyrë efektive me të tjerët; për të përdorur gjuhën e duhur të trupit, për të përshtatur tonin, shpejtësinë dhe volumin e zërit. Komunikuesit e mirë mund ta përdorin komunikimin në mënyrë efektive për qëllime të ndryshme (p.sh. për të informuar, udhëzuar, motivuar, bindur, dhe zgjidhur konflikte) në mjedise të ndryshme.

- | | |
|--|--|
| <input type="checkbox"/> Jam i vetëdijshëm për rëndësinë e komunikimit të mirë në jetë dhe në punë | <input type="checkbox"/> Mund ta përshtas gjuhën në kontekstin shoqëror |
| <input type="checkbox"/> Komunikoj idetë në mënyrë të qartë dhe drejtpërdrejtë për të informuar dhe udhëzuar të tjerët | <input type="checkbox"/> Vazhdimisht demonstroj dëgjim aktiv përmes gjuhës së trupit, shprehjeve të fytyrës dhe tonit të zërit |
| <input type="checkbox"/> Komunikoj idetë në mënyrë bindëse | <input type="checkbox"/> Përdor specifika, jap shembuj dhe detaje |
| <input type="checkbox"/> Përdor gjuhë të saktë për të përcjellur mesazhin | <input type="checkbox"/> Komunikoj me edukatë dhe qetësi në situata të tensionuara |
| <input type="checkbox"/> Zakonisht përdor forma të sakta gramatikore kur flas ose shkruaj | <input type="checkbox"/> Reflektoj për komentet dhe jap komente të matura/menduara |

Zgjidhja e problemeve

Zgjidhja e problemeve lidhet me shkathtësinë për të zgjidhur probleme të ndryshme të panjohura, përmes zgjidhjeve praktike dhe kreative. Procesi i zgjidhjes së problemit përfshin identifikimin e problemit, analizimin e problemit për të gjetur faktorët apo shkaktarët që kontribuojnë në situatën e padëshiruar, gjenerimin e opsioneve të mundshme për të zgjidhur situatën, vlerësimin e opsionit më të mirë, implemetimin e intervenimit dhe vlerësimin e efektivitetit të intervenimit.

- | | |
|---|--|
| <input type="checkbox"/> Jam i vetëdijshëm për metoda të përshtatshme për zgjidhjen e problemeve | <input type="checkbox"/> Mund të shpjegoj arsyet përse kam bërë një zgjedhje të tillë |
| <input type="checkbox"/> Demonstroj shkathtësi për të kuptuar problemin duke e përmbledhur shprehur atë me fjalë të tjera | <input type="checkbox"/> Implementoj zgjidhjen për të cilën jam përcaktuar |
| <input type="checkbox"/> Përcaktoj njohuritë, shkathtësitë dhe strategjitë e nevojshme/dobishme për të zgjidhur një problem | <input type="checkbox"/> Vlerësoj zgjidhjen e implementuar |
| <input type="checkbox"/> Gjej zgjidhje të përshtatshme | <input type="checkbox"/> Kërkoj koment për zgjidhjen që kam bërë |
| <input type="checkbox"/> Krijoj dhe vlerësoj zgjidhje alternative kur është e përshtatshme | <input type="checkbox"/> Dokumentoj/shënoj zgjidhjen që kam bërë për të lehtësuar zgjidhjen e problemeve në të ardhmen |

Kreativiteti

Kreativiteti paraqet shkathtësinë për të përdour informacione dhe resurse të tjera (kohën, njerëzit, paratë, materialet) në mënyrë kreative për të bërë apo krijuar diçka. Përfshin shkathtësinë për të ardhur me ide të reja, inovative, dhe origjinale.

- Jam i vetëdijshëm për aspekte të ndryshme të kreativitetit që lidhen me jetën dhe punën
- Me entuziazëm eksploroj koncepte/ide të reja
- Personalisht bëj kërkime/hulumtime për të gjetur zgjidhje të reja
- Mund të "riformuloj" problemet për t'i parë ato nga një perspektivë tjetër
- Vë në dyshim praktikën ekzistuese për ta përmirësuar atë
- Jap sugjerime inovative në aktivitetet grupore
- Kombinoj idetë e ndryshme në një ide të re, origjinale dhe unike
- Demonstroj fleksibilitet në situata të reja
- Zbatoj idetë dhe njohuritë ekzistuese në situata të reja ose në një mënyrë të ndryshme
- Shpesh shtoj elemente artistike ose estetike në punime

Inteligjenca emocionale

Inteligjenca emocionale i referohet shkathtësisë së një individi për të kuptuar emocionet e tij/saj dhe emocionet e të tjerëve, mënyrës se si individi reagon ndaj të tjerëve, dëgjon, dhe komunikon. Inteligjenca e lartë emocionale do të thotë se një person ka më shumë gjasa për të shprehur emocionet e tij/saj në mënyrë të drejtë dhe jo të dhunshme dhe të tregojë ndjeshmëri duke kuptuar emocionet e atyre me të cilët ajo/ai punon. Kjo ndihmon në përmirësimin e marrëdhënieve në punë/shkollë dhe rritjen e performancës.

- Jam i vetëdijshëm për rëndësinë e inteligjencës emocionale në jetë dhe punë
- Menaxhoj emocionet personale, sidomos ato negative
- Ndaj kohë për reflektim të qetë
- Demonstroj durim dhe dëgjoj me vëmendje pikëpamjet e të tjerëve
- Demonstroj që jam i vetëdijshëm për vetitë personale të forta dhe të dobëta
- Qetësoj situatat e tensionuara shpejt
- Demonstroj shkathtësi për të parë gjërat nga pikëpamja e të tjerëve
- Demonstroj shkathtësi për të kuptuar nevojat dhe dëshirat e të tjerëve
- Trajtoj të tjerët në mënyrë të barabartë dhe me respekt
- Përgjigjem pozitivisht ndaj kritikave

Ndërgjegjshmëria

Ndërgjegjshmëria i referohet tendencës për të qenë i disiplinuar, i sinqertë, i përgjegjshëm, punëtor, dhe i orientuar nga detajet. Karakteristikat e kësaj shkathtësie përfshijnë nivel të lartë të planifikimit, me kontrollë të mirë të impulsit, sjellje të orientuara nga qëllimet, dhe organizim për të arritur afatet dhe qëllimet.

- Jam në gjendje të shpjegoj pse ndërgjegjshmëria është shkathtësi e rëndësishme për jetë dhe punë
- Ndjek udhëzimet për të përfunduar një detyrë
- Përfundoj detyrat në mënyrë të pavarur dhe pa mbikëqyrje
- Prioritizoj kohën në mënyrë efektive për të përfunduar detyrën
- Zbatoj kritere relevante për të gjykuar suksesin e detyrës së përfunduar
- Demonstroj vetë-reflektim dhe vetë-vlerësim
- Jam i përpiktë
- Jam i besueshëm
- Jap mendime të sinqerta
- U kundërvihem sjelljeve joetike

Këmbëngulësia

Këmbëngulësia përfshin shkathtësinë për të vazhduar drejt arritjes së qëllimit kur haset në situata sfiduese dhe barrierë, derisa të arrihet qëllimi i paracaktuar. Kjo shkathtësi përfshin kapacitetin për t'u përgjigjur me qëndresë ndaj situatave sfiduese dhe të vështira.

- Jam në gjendje të shpjegoj se pse këmbëngulësia është shkathtësi e vlefshme për jetë dhe punë
- Jam në gjendje të jap një shembull kur kam kapërcyer një pengesë dhe kam pasur sukses
- Punoj vazhdimisht drejt qëllimeve
- Mbaj fokusin gjatë kryerjes së detyrave
- Zakonisht përfundoj detyrat me sukses
- Reagoj pozitivisht ndaj sfidave dhe vështirësive duke mbajtur të njëjtin nivel të përpjekjes
- Demonstroj përpjekje në situata të vështira ose jomotivuese
- Provoj qasje të ndryshme ndaj problemeve derisa të zgjidhen
- Mbaj besimin dhe standardet personale përballë presioneve të padrejta
- Refuzoj të dorëzohem edhe nëse të tjerët e bëjnë këtë

Puna ekipore

Puna ekipore përfshin shkathtësinë për të punuar në mënyrë efektive dhe me respekt në grupe diverse. Anëtarët e ekipit duhet të tregojnë vullnetin për të udhëhequr, për të kontribuar me ide të reja, për të ndihmuar të tjerët dhe për të marrë përsipër përgjegjësitë e ndara për një punë bashkëpunuese. Është shumë e rëndësishme të ketë mirëkuptim ndërmjet anëtarëve të ekipit, gjë që arrihet përmes gatishmërisë për të dëgjuar idetë e të tjerëve, duke marrë dhe dhënë sugjerime konstruktive dhe duke bërë kompromise për të arritur qëllimet e përbashkëta.

- Jam në gjendje të shpjegoj se pse shkathtësia e punës në grup është e vlefshme për jetë dhe punë
- Bëj pyetje relevante rreth tjerëve
- Dëgjoj me respekt folësit e tjerë
- Marr pjesë në bisedë pa e imponuar mendimin personal
- Parashtrij pyetje dhe probleme relevante
- Demonstroj gatishmëri për të udhëhequr
- Demonstroj miqësi dhe mirëkuptim në grup
- Mirëpres kontributin e secilit anëtar të ekipit
- Inkurajoj nxënësit tjerë për të marrë pjesë në punë ekipore dhe frymëzoj veprimet e të tjerëve
- Negocioj dhe bëj kompromise të nevojshme për të arritur një qëllim të përbashkët

Shkathtësia hulumtuese

Shkathtësitë hulumtuese i referohen shkathtësisë për të identifikuar burimet e të dhënave dhe mbledhur informacione për qëllime të ndryshme (p.sh. zgjidhjen e problemeve, dhënien e deklaratave). Shkathtësitë e mira hulumtuese tregojnë që një individ është i aftë të përdorë teknologjinë si mjet për të hulumtuar, qasur, dhe menaxhuar informacionet në mënyrë të përshtatshme. Është e rëndësishme që individ të jetë i aftë të vlerësojë cilësinë dhe rëndësinë e burimeve dhe të jetë i vetëdijshëm për plagjiaturë.

- Mund të jap shpjegim për nevojën për hulumtime selektive
- Jam i vetëdijshëm për metodat e dobishme për të kundërshtuar informacionin e rremë
- Kuptoj dallimin midis raportimit subjektiv dhe objektiv
- Demonstroj vetëdije se si e vërteta mund të manipulohet
- Përdor lloje të ndryshme burimesh të përshtatshme për të mbledhur informacion
- Jam në gjendje të krijoj dhe të përmbledh informacion pa plagjiaturë
- Analizoj dhe klasifikoj informacionet në mënyrë që të përzgjedh ato që janë relevante dhe përkatëse
- Vlerësoj saktësinë, relevancën dhe autoritetin e informacionit
- Përcaktoj kur është siguruar informacion i mjaftueshëm për të përfunduar një detyrë
- Përdor informacionin në mënyrë të përshtatshme

Shkathësia e ndërmarrësisë

Shkathësia e ndërmarrësisë përfshin gatishmërinë për të marrë iniciativa për projekte të reja dhe inovative dhe shkathësinë për t'i shndërruar ato ide në veprime. Një sipërmarrës i mirë është në gjendje të komunikojë vizionin dhe idetë që të frymëzojë të tjerët ta ndjekin me përkushtim. Implementimi i suksesshëm i ideve kërkon shkathësi për të planifikuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive projektet dhe gatishmërinë për të ndërmarrë rreziqe, duke qenë i vetëdijshëm për pasojat dhe kufizimet.

- Jam i vetëdijshëm për shkathësitë ndërmarrëse dhe udhëheqëse
- Marr iniciativa dhe vendime
- Shndërroj idetë kreative në veprim
- Vlerësoj, peshoj dhe menaxhoj rreziqet
- Planifikoj shfrytëzimin e burimeve (paratë, njerëzit, kohën)
- Paraqes vizion dhe plan proaktiv për ta shoqëruar atë
- Marr pjesë në një proces të vazhdueshëm përmirësimi dhe planifikimi
- Parashikoj dhe planifikoj në detaje hapat e nevojshëm për të përfunduar detyrën
- I përgjigjem dështimit pozitivisht dhe e shoh dështimin si mundësi për të mësuar
- Tregoj gatishmëri për të riplanifikuar ose filluar përsëri kur mësoj gjëra të reja